



Moderator: Mr. Ilir Pilku, MSc.
Regional Senior Agriculture
Expert, Albania

Key speaker: Mr. Raimund Jehle,
FAO Representative in Albania
and Regional Programme Leader

Panelists:

Mr. Enio Civici, Vice Minister of
Agriculture and Rural
Development, Government of
Albania

Ms. Daniela Di Gianantonio, Digital
Agriculture Team Leader, FAO

Ms. Milda Krauzlis, RIS Program
Manager, European Institute of
Innovation & Technology (EIT)
Food

Ms. Marija Tanasoska, Deputy
Regional Team Leader, USAID
CATALYZE Western Balkan
Engines of Growth

Mr. Marco Brini, Digital
Agriculture Expert

Mr. Blagoja Mukanov, MSc.
Founder, AgFutura, Skopje, North
Macedonia

FORUMI EKONOMIK BALLKANIK 2023

“**Forumi Ekonomik Ballkanik** synon të krijojë dhe implementojë metoda të reja dhe zgjidhje kreative për çështjet aktuale ekonomike të vendeve ballkanike në mënyrë që të promovojë rritjen ekonomike, bashkëpunimin rajonal, paqen dhe sigurinë. Forumi Ekonomik Ballkanik mbledhi së bashku drejtues biznesi, liderë ndërkombëtarë, zyrtarë qeveritarë, akademikë, studentë dhe institucione financiare me qëllimin e krijimit të diskursit në përgjigje të qëllimeve të renditura më sipër”.

Një nga sesionet tërheqëse në këtë forum, dhe që organizohej nga NOA, lidhej me investimet në ngritjen e aftësive profesionale, dixhitalizimin e biznesit dhe zonave rurale, diversifikimin e aktiviteteve, ofrimin e shërbimeve bazë në zonat rurale dhe përmirësimin e infrastrukturës rurale.

Pjesëmarrës direkt në këtë sesion ishin drejtues të organizatave ndërkombëtare, funksionarë të institucioneve shtetërore, menaxherë të kompanive inovative në teknologji për agrobiznesin, etj.

“Përdorimi i mjeteve dixhitale si dronët, imazhet satelitore dhe sensorët mund të çojnë në bujqësi precize, e cila optimizon inputet, rrit rendimentet dhe minimizon ndikimin mjedisor dhe kërkohet të jenë pjesë e politikave bujqësore zhvilluese” – u shpreh Z.Raimund Jehle, përfaqësues i FAO- s për Shqipërinë dhe Znj. Daniela Di Gianantonio, drejtuese e programit dixhital pranë FAO-s.

Teknologjitë bashkohore në bujqësi, që menaxhojnë riskun klimaterik, por jo vetëm, efektet e tyre pozitive në mbarëvajtjen e aktiviteteve bujqësore, ishin pjesë e prezantimeve nga ekspertët inovativë, Z.Marco Brini dhe Z.Blagoja Mukanov.

Znj. Milda Krauzlis, manaxhere e Institutit Europian të Inovacionit dhe Teknologjisë, theksoi rëndësinë e mbështetjes së projekteve inovative Start-Up me të rinjtë.

“Ndërsa prodhimi bujqësor shndërrohet në zinxhirë tregu më të integruar dhe komplekse, financimi i zinxhirit të vlerës merr një rëndësi të veçantë, duke ndihmuar në lidhjen e fermerëve me pjesën tjetër të zinxhirit” - u shpreh drejtuesja rajonale e projektit të USAID me qendër në Shkup.